



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TE PERGJITHSHEM
DREJTORIA KUNDER KRIMIT TE ORGANIZUAR

PROCES VERBAL

Mbi deklarimet e personit qe ka dijani per rrethana te procedimit penal

Ne Tirane, ne Seline e Kryeministrit, sot me daten 17.02.2005, ne prokuroret e Prokurorise se Pergjithshme, Zamir Shtylla dhe Arben Kraja, ne mbeshtetje te neneve 315 dhe 162 te Kodit te Procedures Penale marrim ne pyetje me cilesine e personit qe ka dijani per rrethanat e dobishme per qellimin e hetimit te procedimit penal nr 1, te vitit 2004, shtetasin Fatos Nano.

Pyetje: Ne daten 09.11.2004, kemi paraqitur kerkese ne Prokurorine e Pergjithshme, per te zhvilluar hetime lidhur me materialet e bera publike ne cilesine e deputetit te Kuvendit te Shqiperise nga Z.Nikoll Lesi, gjate seances plenare te dates 08.11.2004.

Bazuar ne nenin 284 te Kodit te Procedures Penale, per vepren penale te shpifjes per shkak te detyres, parashikuar nga neni 240 i Kodit Penal, ndjekja penale mund te filloje vetem me ankimin e te demtuarit. Nga ana juaj keni ose jo ankim per te ushtruar ndjekjen penale?